



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 duke u bazuar në nevojën e Komunës për trajnimin dhe çertifikimin e zyrtarëve komunal, konform edhe kërkesës së Zyrtarit Kryesor Financiar drejtuar Ministrisë së Financave dhe Transfereve dhe shkresës së dërguar përmes emailit zyrtar me datë 13.10.2021 nga Zyrtarja për trajnim dhe zhvillim në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve për plotësimin e dokumentacionit shtesë lidhur me trajnimin ,Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E ZYRTARES ALTERNATIVE PËR PRANIM TË MALLIT

- I. **SHEHIDE SOPA IBRAHIMI**, Zyrtare për partneritet publiko privat në kuadër të Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim **CAKTOHET**, Zyrtare alternative për pranim të mallit, si detyrë shtesë në kuadër të detyrave të punës.
- II. Zyrtarja e cekur në pikën I të këtij Vendimi do ti kryej detyrat si **Zyrtare alternative për pranim të mallit** në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse menjëherë pas përfundimit të trajnimit dhe çertifikimit për pozicionin e cekur në pikën I të këtij Vendimi.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtën të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Sektori për Personel dhe Zyrtarja Shehide Sopa Ibrahim.

1Nr. 1-112/06-21737
Lipjan, më 28.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE TË KLUBEVE SPORTIVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONEVE PËR VITIN 2022

Neni 1

Me këtë Vendim, **Ramiz Gashi**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive përfituese të subvencioneve për vitin 2022.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive si vijon :

Nr.	Emërtimi i klubit sportiv
1.	KF "Ulpiana-1926" - Lipjan
2.	KF "Arbëria" - Dobrajë e Madhe
3.	KV "Ulpiana" femrat - Lipjan
4.	KF "Veteranët"
5.	KV "Skenderbeu"
6.	SHPSSH - Lipjan
7.	KV "Ulpiana" meshkujt - Lipjan
8.	KB "Ulpiana" - Lipjan
9.	KF "Minatori"
10.	SHF "Minatori"
11.	KV "Shpella e Mermerit"
12.	KF "Ulpiana-1992" - Lipjan
13.	KSH "Ulpiana"
14.	KA "Blinaja"
15.	KH "Ulpiana" meshkujt

16.	KGJ "Lipjani"
17.	KH "Ulpiana" femrat
18.	KSH "Ced Elita"
19.	KB "Lipjani"

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të klubeve të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-21431

Lipjan, më 27.04.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer 15-400-21921 i datës 29.04.2021, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer Nr.15-400/01-17272 të datës 31.03.2022 si dhe Listës përfundimtare të përfituesve të serave të publikuara nga Komisioni 1Nr.320-77083 të datës 20.12.2021, pas përfundimit të procedurave të ankesave, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR
FERMERË

Neni 1

I. **OBLIGOHET**, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej **330.160 €** (treqind e tridhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro) konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer 15-400-21921 i datës 29.04.2021 dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer Nr.15-400/01-17272 të datës 31.03.2022 me qëllim të subvencionimit të fermerëve të komunës së Lipjanit me nga një serrë në sipërfaqe prej 50m².

II. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.


IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-21641
Lipjan, më 28.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Rregullores 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme në pajtim edhe me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale 06/L-082, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR EMËRIMIN E ZYRTARËVE PËRGJEGJËS

Neni 1

I.Me këtë Vendim, **Zoran Stojanovic**, Kryetar i komisionit komunal për kthim dhe **Lidija Jovanovic**, zyrtare në Zyrën Komunale për komunitetet dhe kthim **EMËROHEN** zyrtarë përgjegjës të cilët do të pranojnë aplikacionet dhe do të regjistrohen në DB (baza e të dhënave në MKK).

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë

Zyrtarët e cekur në nenin 1 do të kenë qasje në bazën e të dhënave të MKK –Ministrisë për Komunitete dhe Kthim .

Zyrtarët e lartëcekur gjatë punës së tyre do të veprojnë në harmoni me dispozitat e Rregullores 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme , dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në koordinim të vazhdueshëm edhe me zyrtarët përgjegjës të MKK-së.

Neni 3
Hyrja në fuqi


Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Ministria për Komunitetet dhe Kthim dhe zyrtarët përgjegjës të cekur në nenin 1 .

1Nr. 112/02-19040
Lipjan, më 13.04.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores (QRK)- NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, udhëzuesit për zbatimin e Rregullores, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR KTHIM**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni komunal për kthim, në përbërje:

1. Zoran Stojanovic, ZKKK - kryesuesë
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtarë
3. Rozeta Selimi, DSHPS, anëtare
4. Lorik Bërbatovci, Zyrtar në QPS, anëtar
5. Rafete Retkoceri, DSHP, anëtare
6. Hana Berisha, DPUMM, anëtare
7. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtarë
8. Miodrag Djekic, MKK-ja, anëtarë

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit komunal për kthim**

Komisioni komunal për kthim do të kryejë detyrat në bazë të dispozitave të Rregullores (QRK) – NR. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme si dhe udhëzuesit për zbatimin e Rregullores.
Mandati i Komisionit është 3 vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandatë shtesë.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.020/04-16922 i datës 30.03.2022

1Nr.020/04-16922/2
Lipjan, më 08.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIMIN E PROJEKT-RREGULLORES PËR VARREZAT,
OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E
TYRE

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për ndryshim dhe plotësimin e Projekt-Rregullores për Varrezat, Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre, në këtë përbërje:

1. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, kryesuese,
2. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, anëtar dhe
3. Valdete Muji, Zyrtare Ligjor në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të hartoj Projekt-Rregullorën për ndryshim dhe plotësimin e Projekt-Rregullores për Varrezat, Ofrimin e Shërbimeve të Varrimit Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e tyre, konform dispozitave përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri me 15.05.2022.


Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohen kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 1-112/02-20053
Lipjan, më 20.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 1 e datës 12 .01.2012, Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

I. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e banesore, në këtë përbërje: (në vazhdim të tekstit Komisioni)

1. Hasim Vishesella, Kryetar i Komisionit
2. Lumnije Ejupi , anëtare e Komisionit
3. Ramadan Hoxha, anëtar i Komisionit
4. Shahadije Ibrahim, anëtare e Komisionit

II. Komisioni, për zbatimin e dispozitave të Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 12 .01.2012 dhe dispozitave të Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 , autorizohet si vijon :

1. Kompletton shënimet e kërkuara me Ligjin e cekur për banesat në pronësi të Komunës të cilat ende nuk janë blerë nga bartësit e të drejtës banesore.

2.Njofton bartësit e së drejtës banesore, përkatësisht shfrytëzuesit e banesës për të drejtën për blerjen e banesës dhe dokumentacionin i cili duhet t'i bashkëngjitet kërkesës në pajtim me Ligjin.

3.Shqyrton kërkesat e bartësve të së drejtës banesore për banesat të cilat dhënësi i banesave është Komuna si dhe për banesat për të cilat do të vërtetohet paraprakisht se nuk iu dihet kush do të jetë shitësi konform dispozitave të nenit 10 të Ligjit bazik.

4.Në pajtim me Ligjin, me dëshmi përkatëse vërteton se a është parashtruesi i kërkesës në grupin e personave që e kanë të drejtën për blerjen e banesës.

5.Në rast të kërkesave të paprecizuara dhe të dokumentacionit të pakompletuar s kërkon nga parashtruesi i kërkesës precizimin e kërkesës dhe kompletimin e dokumentacionit.


6.Pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesave nxjerr Vendimin përkatës dhe lidhur me kërkesat e aprovuara përgatit për nënshkrim Kontratën e shitblerjes në pajtim me Ligjin.

7. Gjatë gjithë punës së tij, Komisioni është i obliguar t'i përmbahet procedurave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 .

III. Punët administrative – teknike për Komisionin i kryen Sektori pronëso- juridik, ndërsa për kërkesat të cilat i plotësojnë kushtet e blerjes, Komisionit në kalkulimin e çmimit të shitjes do t'i ndihmojë Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

IV. Me Vendim të njoftohen Kryetari dhe anëtarët e Komisionit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori Pronëso- Juridik .

1Nr. 020/04-21636
Lipjan, më 28.06.2022





Në bazë të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 të Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës Nr. 2003/22 si dhe nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110/78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KUSHTEVE SANITARO –
TEKNIKE

I. Komisioni themelohet në përbërje prej:

1. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastrukturë , kryesues;
2. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
3. Shehide Sopa, Ibrahim, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
4. Burim Kodra, Drejtorati për Inspektorat, anëtar rezervë

II. Detyrat themelore dhe përgjegjësitë e Komisionit

Në procedurën e dhënies së lejeve ndërtimore për ndërtimin e objekteve ndërtimore, Komisioni i themeluar shqyrton dokumentacionin teknik dhe jep pëlqimin për harmonizimin e projektit kryesor me kushtet sanitaro – teknike të ndërtimit.

Dokumentacioni për pëlqimet sanitaro – teknike bëhet për projektet kryesore të objekteve të kategorisë së II-të.

Komisioni i themeluar, bënë shqyrtimin e dokumentacionit për dhënien e pëlqimit brenda tetë (8) ditësh pas pranimit të dokumentacionit për shqyrtim. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, e dorëzon me kohë dokumentacionin teknik te Komisioni, duke pasur parasysh që Komisioni të kryej detyrat e caktuara brenda afatit ligjor për dhënien e përgjigjes për leje ndërtimore.

Në rastet kur dokumentacioni i shqyrtuar ka nevojë të plotësohet apo ndryshohet, atëherë Komisioni përmes Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit kërkon nga parashtruesi i lëndës që brenda pesë (5) ditësh të bëjë përmirësimet e caktuara.

Në rastet se ndonjëri nga anëtarët në numrat rendor 1,2,3 ka konflikt interesi për ndonjë lëndë të caktuar do të zëvendësohet nga anëtari rezervë në numrin rendor 4.

III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe do të zbatohet deri në një Vendim tjetër.

A r s y e t i m

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës, është përcaktuar marrja e pëlqimit sanitar para dhënies së lejes ndërtimore. Meqenëse nga fillimi i vitit 2022 inspektorët sanitar komunal kanë kaluar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, vendet e inspektorëve sanitar komunal kanë mbetur të pa mbuluara dhe si rrjedhojë e kësaj çështjet për pëlqime sanitare lidhur me projektin kryesor nuk mund të shqyrtohen.

Për sqarimin e kësaj çështjeje, me datën 25.03.2022 i kemi drejtuar një shkresë Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe të njejtën ditë kemi pranuar përgjigjen nga Agjencia se nga ana e tyre nuk mund të ofrohet ndonjë zgjidhje.

Prandaj, të ndodhur në këtë situatë të krijuar, si dhe duke pasur parasysh detyrimet e përcaktuara me nenin 17 dhe 21 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtimin, u vendos të themelohet Komisioni për shqyrtimin e kushteve sanitaro – teknike të projekteve kryesore, ashtu edhe siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohen:

Të emëruarit në Komisionin e caktuar;
DPUMM

01 Nr. 020/oh-18098
Lipjan, më 06.04.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **6,090.00€**, (gjashtë mijë e nëntëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-17163 të datës 01.04.2022, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 29 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin mars të vitit 2022 me nga 210 euro për secilin rast $29 \times 210 = 6,090.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI – dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

INr.400/01-17163

Lipjan, më 05.04.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të (klubet sportive) Nr.5-453-16883 të datës 30.03.2022, Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-400/01-18822 të datës 12.04.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË (KLUBET SPORTIVE) PËR
VITIN 2022

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **110,000.00 €** (njëqind e dhjetmijë e euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-të (klubet sportive) të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2022, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-400-7857 e datës 09.02.2022, ku gjithë procedura që nga shpallja publike e deri në nxerrjen e këtij Vendimi është zhvilluar konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të (klubet sportive) përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për vitin 2022:

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve (klubet sportive)	Shuma
1.	KF "Ulpiana-1926" - Lipjan	40,000.00 €
2.	KF "Arbëria" - Dobrajë e Madhe	25,000.00 €
3.	KV "Ulpiana" femrat - Lipjan	4,000.00 €
4.	KF "Veteranët"	1,500.00 €
5.	KV "Skenderbeu"	5,000.00 €
6.	SHPSSH - Lipjan	1,500.00 €
7.	KV "Ulpiana" meshkujt - Lipjan	4,000.00 €
8.	KB "Ulpiana" - Lipjan	2,500.00 €
9.	KF "Minatori"	6,000.00 €
10.	SHF "Minatori"	1,500.00 €
11.	KV "Shpella e Mermerit"	2,500.00 €
12.	KF "Ulpiana-1992" - Lipjan	4,000.00 €

13.	KSH "Ulpiana"	1,500.00 €
14.	KA "Blinaja"	1,500.00 €
15.	KH "Ulpiana" meshkujt	1,500.00 €
16.	KGJ "Lipjani"	1,500.00 €
17.	KH "Ulpiana" femrat	2,500.00 €
18.	KSH "Ced Elita"	1,500.00 €
19.	KB "Lipjani"	2,500.00 €
	Shuma Totale	110,000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2022 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe klubeve sportive do të rregullohen në Kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe secilit klubë veq e veq.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.400-18822

Lipjan, më 13.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN


Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjetet taksi 15Nr.011-29428 të datës 02.05.2019 si dhe nenit 1 të Rregullores 15-345-70953 të datës 31.10.2019 për ndryshimin dhe plotësimin regullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-29428 të datës 02.05.2019, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR SHPALLJEN E NJOFTIMIT PUBLIK**

- I. **OBLIGOHET**, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim që **TË SHPALLË** Njoftimin publik për dhënie e licencave për ushtrimin e veprimtarisë për transportin e udhëtarëve me automjete taksi konform dispozitave të Ligjit për Transportin rrugor , Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjetet taksi 15Nr.011-29428 të datës 02.05.2019 dhe Rregullores 15Nr.345-70953 të datës 31.10.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-29428 .
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

1Nr.020/04-20084
Lipjan, më 27.04.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E EKIPIT KOMUNAL PËR ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E
HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

Neni 1
Përbërja

Themelohet, Ekipi komunal për zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës-HZK, në përbërje si vijon:

1. Hasim Vishesella , DPUMM, Koordinator i EKZM
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Shehide Sopa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim , anëtare
4. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
5. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
6. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
7. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ekipit komunal (EKZM)

Ekipi komunal për zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me dispozitat për zbatimin hartës zonale të Komunës dhe përgjithësisht kryen punët si vijon:

Koordinatori i EKZM zgjidhet për 12 muaj, pastaj viteve në vijim koordinatori zgjidhet me rotacion poashtu për 12 muaj nga anëtarët e drejtorive sektoriale pjesë e EKZM .

Koordinatori i EKZM kryen rolin e sekretariatit, duke mbledh dokumentacionin e nevojshëm nga drejtoritë dhe institucionet tjera, përgatitjen e takimeve te rregullta, përcakton personin për mbajtjen e minutave nga takimet, shpërndan ftesat dhe dokumentacioni e mbledhur, dhe çdo detyre tjetër qe mund te rrjedh ne qellim te mbarëvajtjes se punës se EKZM.

Me qellim te zbatimit te HZK-se, EKZM ka për detyrë të përpiloj planet vjetore sektoriale, te cilat janë ne harmoni me kërkesat për zbatim te HZK-se, për secilën drejtori komunale. Këto plane sektorale finalizohen dhe shpërndahen tek te gjitha drejtoritë ne afat kohor te

mjaftueshëm qe siguron integrimin e tyre ne planin financiar komunal final qe trajtohet nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, me qellim te përfshirjes ne buxhetin e ardhshëm komunal.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Koordinatori dhe anëtarët e tjerë të ekipit komunal.

Nr. 01-350/01-17172
Lipjan, më 01.01 .2022



Imri AHMETI

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË PERFORMANCËS NË KOMUNËN E LIPJANIT
TË EMËRUAR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2021

I.Me këtë Vendim, **zëvendësohet**, anëtari i pestë i Vendimit për Emërimin e grupit të performancës në Komunën e Lipjanit për hartimin e raportit të performancës për vitin 2021, Haqif Rrustemi (fusha e menaxhimit të fatkeqësive) i caktuar sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.1-020/02-16384 i datës 28.03.2022 dhe në vend të tij caktohet:

GAFURR HETEMI, Zyrtar për Çështje Pronësore-Juridike

II.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:
Koordinatorit të performancës, Shemsi Azemi
Zyrtarit, Gafurr Hetemi

1Nr.1-020/02-16384 /2
Lipjan, 20.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2019 për kerkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të ndërtimeve, si dhe nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

I. Për themelimin e Komisionit Punues për shqyrtimin e kërkesave, përkatësisht lëndëve të pranura nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për trajtimin-legalizimin e ndërtimeve pa leje për objektet e kategorisë së II-të, të cilat nuk janë shtëpi banimi.

II. Komisioni Punues themelohet në përbërje prej:

1. Hasim Vishesella, kryesues
2. Hasan Hajdini, anëtar
3. Enver Elshani, anëtar

III. Detyrat e Komisionit Punues

Komisioni Punues inspekton kërkesat themelore për shëndet dhe siguri në punë në përputhje me Ligjin Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2019 për kerkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të ndërtimeve, duke përfshirë:

1. Gjendjen ekzistuese të objektit dhe krahasimin me dokumentacionin e dorëzuar;
2. Strukturën/elementet konstruktive të ndërtesës;
3. Rrjetin e ujit dhe kanalizimit;
4. Elektrikës;
5. Instalimet makinerike; dhe
6. Masat mbrojtëse kundër zjarrit.

Kërkesat themelore sipas nr. rendor 1 dhe 2 inspektohen nga Kryesuesi i Komisionit, kurse kërkesat tjera nga anëtarët tjerë të Komisionit varësisht prej profileve profesionale.

Pas inspektimit të kërkesave, secili nga anëtarët e Komisionit Punues plotëson pjesën e caktuar të Shtojcës 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2019 për kerkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të ndërtimeve.

IV. Mandati i Grupit Punues do të jetë deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesave në përputhje me Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

V. Ky Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Me këtë Vendim njoftohen:

Anëtarët e Komisionit Punues dhe
DPUMM

01 Nr. 020/06-18105
Lipjan, më 06-04-2022



Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës